

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E RRETHIT GJYQESOR
VLORE

Nr.2023 Akti
Datë 26.11.2015

Nr.1758 Vendimi
Datë 21.12.2015

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI (RROKAJ)

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 21.12.2015 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile nr.2023 Akti, që u përket palëve :

PADITES: **Bledar Zani**, i biri i Bashkimit i datelindjes 18.07.1979 banues ne Bulevardin Ismail Qemali Lagja Isa Boletini Pall.292, Kati i pare Vlore (ne mungese)

TE PADITUR: **Drejtoria Rajonale e STimeve Vlore** (ne mungese).
Drejtoria e Apelimit Ttaimore prane Drejtorise se Pergjithshme te Ttimeve (ne mungese)

Me pjesemarrjen e avokatures se shtetit Zyra vendore Vlore (ne mungese).

Objekti: Shfuqizimin e aktit administrativ " Njoftim vleresimi per detyrimet" nr.10328 prot, date 02.09.2015 te Drejtorise Rajonale te Ttimeve Vlore.

Baza ligjore: Nenet 15 dhe 17/a dhe c te ligjit 49/2012 "Per gjykatat administrative" te ndryshuar nenet 50, 55/1

Gjykata, në seancën gjyqësore të datës 21/12.2015, konform nenit 25 të ligjit nr.49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'

V Ë R E N

Se paditësi Bledar Zani i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Në seancën pregatitore të datës 21.12.2015, ora 09.30, paditësi Bledar Zani paraqiti një kërkesë me shkrim ku me vullnetin e plotë , të lirë dhe të pavesuar konform nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile kërkon të heqi dorë nga gjykimi i kësaj çështje civile .

Neni 39 i ligjit nr.49/2012 2012 i ligjit 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' parashikon se " *Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.*

Sa sipër, gjykata bazuar në nenet 39 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 të ligjit 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' dhe nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile, çmon se kjo çështje duhet pushuar për paditësin Bledar Zani.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata, bazuar në nenin 127 të K.Pr.Civile, nenet 25 dhe 39 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimi ne gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' dhe nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile.

VENDOSI

- Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr.2023 Akti, datë 26.11.2015 rregjistrimi me palë paditëse Bledar Zani.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda pese diteve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.
- U shpall në Vlorë, sot më datë 21.12.2015.

SEKRETARE

Edlira SHEHU

GJYQTARE

Gentiana XHELILI (RROKAJ)